



LAJME nga FONDACIONI
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË
Tiranë

N.16
Prill
2025

Redaksia "ZKM ALBANIA"
Kompleksi Spitalor Universitar
"Zoja e Këshillit të Mirë"
Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë

unikzkm
unikzkm
www.unizkm.al
pr@fzkm.org

EDITORIAL

NA TAKON NE TË JEMI PROTAGONISTËT E TË RESË PËR TË MIRËN E PËRBASHKËT

Pas Papa Françeskut...

Mendimi i përbashkët, i të gjithëve ne që jemi të angazhuar në Fondacionin Zoja e Këshillit të Mirë në Tiranë na kthen në kohë më 21 shtator 2014 kur **Papa Françesku** vizitoi Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" për t'u takuar me udhëheqësit e besimeve të ndryshme fetare të pranishme në Shqipëri.

Mësuam me trishtim **lajmin për ndarjen e tij** nga jeta dhe ndiejmë në zemrat tona një ndjenjë të thellë mirënjohjeje, pasi Françesku ka qenë Papa i kësaj kohe: njeri i paqes dhe i guximit, i dialogut dhe i singëritetit, i besimit dhe i kërkimit.

Françesku vdiq si gjithë njerëzit e mëdhenj, i papërfunduar në misionin e tij duke na lënë si trashëgimi vazhdimin e një veprë për të mirën e përbashkët të botës dhe të kishës. Dymbëdhjetë vitet e shërbimit të tij kanë hedhur themelet për të krijuar të renë **që namëson mesazhi i Ungjillit**, pasi jetojmë në një ndryshim epokal ku nuk mund të jemi indiferentë.

Komuniteti ynë i madh i rritur ndër vite nga Universiteti deri tek Spitali Katolik do t'ia kushtojë **festën e Fondacionit të 29 prillit 2025** Papa Françeskut, me Meshën e Shenjtë të drejtuar nga Arqipeshkvi Metropolit i Arqidioqezës Tiranë-Durrës Imzot Arjan Dodaj në orën 17:00 në "Aula Magna". Françesku na ftoi të përjetojmë gëzimin e Ungjillit ("Evangjeli Gaudium") dhe ne dëshirojmë ta shprehim këtë përmes lutjes dhe haresë.

Deri në zgjedhjen e Papës së ri, në orën 08:30, **Mesha e Shenjtë** që kremtohet në Kapelën e Spitalit Katolik ZKM do të ketë një qëllim lutjeje për Papa Françeskun dhe për atë që do ta pasojë në shërbesën si Ileshkëv i Romës dhe Papë për mbarë botën.



Papa Françesku, me rastin e vizitës së tij në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" – Tiranë, Shqipëri

Ekziston një “dhëmb i tepërt” që përfaqëson një anomali të njohur mirë në odontoiatri, një dhëmb më shumë nga tridhjetë e dy që është numri normal. Ndër “dhëmbët e tepërt” ka një të quajtur meziodens, i vendosur pikërisht në qendër të gojës. Një historian arti, Marco Bussagli, e ka studiuar këtë fenomen në disa vepra arti (piktura dhe skulptura) ndër vite, duke vënë re se është një element plot kuptime.

Ky dhëmb prerës, i vendosur midis katër dhëmbëve të sipërm normalë, përfaqësonte një simbol të qartë të shëmtisë morale (ndonjëherë i pafajshëm) që karakterizon personazhet e larguar nga hiri i Zotit. Në shumë figura të Kapelës Sistine në Vatikan, Bussagli ka vërejtur praninë e mesiodens-it.

Dhe jo vetëm kaq, madje edhe Krishti në veprën e famshme ‘Pietà’ të Michelangelos (në foto), e tregon qartë atë! Artisti i madh toskan donte të tregonte se Jezusi i ka marrë mbi vete vuajtjet tona dhe “përmes plagëve të tij ne u shëruam” (Isaia 53,5).



Bussagli kryen kërkime të pandërprera dhe e dokumenton këtë zbulim përmes disa botimeve, ndër të cilat i fundit është ai i vitit 2023 me titullin “E keqja në gojë. Historia e gjatë e një ikonografie të harruar” (Botimet Medusa).

Le t’ia lëmë profesionistëve të odontoiatrisë, pasionantëve të artit dhe studiuesve të shkencave religjioze që të thellohen në këtë temë. Vëllimi është i disponueshëm në bibliotekën e UKZKM.

Në ditët pas Pashkëve duam të kujtojmë mesazhin e shpëtimit nga Krishti sepse “Perëndia, atë që nuk njohu mëkat, për ne e bëri të jetë mëkat, që të bëhemi ne drejtësi e Perëndisë me anë të tij” (2 Cor 5,21).

Ju urojmë Pashkë të lumtura dhe gëzim të vazhdueshëm. (rv)



T’i dhurosh orët e tua të pushimit një kolegu të prekur nga SLA-ja, skleroza laterale amiotrofike, është një akt solidariteti, një akt Pashke. Kështu kanë zgjedhur të ndihmojnë kolegun e tyre punonjësit e një fabrike në Castelnuovo, në provincën e Trentos (Itali), të cilët përdorën “fondin e tyre të orëve të pushimit” për t’i vënë në dispozicion të njerëzve që kanë nevojë, siç ishte rasti i Gëzim Smoqit.

Ai është një rezident në Itali me origjinë shqiptare i prekur nga kjo sëmundje, por falë mbështetjes së kolegëve të punës po vazhdon trajtimin e tij.

Çdo punëtor në fabrikë vendosi të dhuronte orët e tij pushim. Gëzimi, një punonjës që ka kaluar vite të tëra të jetës së tij brenda dyerve të fabrikës tregoi se sa e preku gjesti i kolegëve të tij. «Nëse jam këtu, është merita e tyre: më dhanë kohën e nevojshme për t’u mjekuar.

Sëmundja kërkon trajtim dhe gjesti i tyre më mundësoi të rizbuloj vlerën e thellë të marrëdhënieve njerëzore, jo vetëm

përmes mbështetjes së kompanisë, por edhe falë operatorëve shëndetësorë që kam takuar». Përmes kësaj mënyre Gëzimi pavarësisht mjekimit dhe ndërprerjes së punës mund të marrë “rrogë të plotë” falë solidaritetit të kolegëve.

Siç ka thënë Fulvia Massimelli, presidente e Shoqatës Italiane të Sklerozës Laterale Amiotrofike: «Jetojmë në një kohë që shpesh duket se mbështet konkurrencën dhe individualizmin. Megjithatë, historia e Gëzimit na tregon se është e mundur për të qenë së bashku.

Na mëson se solidariteti nuk është retorikë, por një zgjedhje konkrete dhe e përditshme.

Se një sipërmarrje mund të jetë gjithashtu një komunitet, se puna mund të jetë përkujdesje».

(Marrë nga gazeta *Avvenire* 18/4/2025)

**Nëse jam këtu,
është merita e tyre**



Toka ka nevojë për ne, tani më shumë se kurrë. E megjithatë prapë harrojmë sepse jemi të përfshirë plotësisht në aktivitetet tona të përditshme dhe të përqendruar tek problemet që e vënë planetin tonë dhe ndryshimet klimatike në plan të dytë. Shikojmë pothuajse në një gjendje pasiviteti përmbytjet, zjarret, tërmetet, shkrirjen e akujve, rritjen e nivelit të deteve dhe shumë fenomene të tjera dhe nuk luftojmë vërtetë për ta mbrojtur shëndetin e planetit, i cili përfshin gjithashtu mirëqenien tonë.

22 prilli, datë që shënon 55-vjetorin e shpalljes së Ditës së Tokës na fton jo vetëm të reflektojmë, por edhe të reagojmë për mbrojtjen e planetit Tokë përmes mesazhit "Our power, our planet": një ftesë e fortë dhe e qartë për të njohur përgjegjësinë individuale dhe kolektive në drejtimin e ndryshimit të domosdoshëm. Fokusi kryesor i këtij viti është përsheptimi i tranzicionit energjetik: burimet e rinovueshme të

energjisë, si ajo diellore, energjia e erës, hidroelektrike dhe gjeotermike si burime të pastra dhe të pashtershme që janë në gjendje të ulin ndjeshëm emetimet e CO₂ dhe varësinë nga lëndët djegëse fosile. Përdorimi i modeleve energjetike të bazuara në burime të rinovueshme nuk është vetëm një zgjedhje mjedisore, por edhe një mundësi e madhe ekonomike dhe shoqërore, çka do të thotë të nxitet inovacioni teknologjik, të krijohen mijëra vende të reja pune të gjelbra, të ulen kostot energjetike në terma afatgjatë dhe të forcohet siguria energjetike.

Të ftojme të njohësh disa tregime nga rajonet e Evropës Lindore në faqen e internetit: www.meridiano13.it
Në foto: panelet fotovoltaike të Kompleksit universitar-sptialor ZKM në Tiranë


TË RINJTË PELEGRINË PËRMES HAPAVE TË SHENJTORËVE

23 korrik – 4 gusht 2025

Me rastin e **dyqindvjetorit të lindjes dhe pagëzimit të të Lumit Luigi Maria Monti**, ju ftojme të merrni pjesë në një pelegrinazh të rëndësishëm, një rrugëtim besimi, zbulimi dhe vëllazërimi. Kjo eksperiencë unike do të na çojë nga Tirana në Milano dhe Romë, ku do të vizitojmë vendet e shenjta, do të marrim pjesë në Jubileun Rinor dhe do të nderojmë trashëgiminë e të Bekuarit Monti.

PROGRAMI

- 23 Korrik** Nisja nga Tirana për në Milano, mbërritja në Cantù
- 24 korrik** Festa e At Montit në Saronno
- 25 korrik:** Cammino Montiano – një rrugë e veçantë në gjurmët e Beato Monti
- 26 korrik** Vizitë në Milano, për të zbuluar trashëgiminë e tij të pasur kulturore dhe shpirtërore
- 27 korrik** Udhëtim nga Milano në Romë
- 29 korrik – 4 gusht** Pjesëmarrja në Jubileun Rinor në Romë
- Vizita në të gjitha bazilikat kryesore të Romës dhe vendet e veçanta që lidhen me At Monti, Kthimi ne Tirane



REGJISTROHU TANI!

Per informacione na kontakto në email
✉ pastorale.universitaria@unizkm.al



bashkëpunimit për të ardhmen premtuese. Në shenjë falenderimi për këtë vizitë të rëndësishme Presidenti i Fondacionit "Zoja e Këshillit të Mirë" i dhuroi Presidentit të Spitalit të njohur në Romë Bambino Gesù Prof. Tiziano Onesti një pllakate përkujtimore të këtij eventit që përmban një frazë të Nënë Terezës e cila jep lutjet e saj për të gjithë ata që do të ndihmojnë Spitalin Katolik



Fondacioni "Zoja e Këshillit të Mirë" mikpriti në Qendrën Spitalore dhe Universitare një delegacion nga Spitali Pediatrik Bambino Gesù i Romës, një strukturë e kualifikuar dhe e njohur në të gjithë botën për kujdesin dhe ndihmën ndaj fëmijëve të sëmurë.

Presidenti i Fondacionit fr. Ruggero Valentini, Rektori i Universitetit Katolik Prof. Leonardo Palombi, Zv. Rektor i UKZKM Edmond Hajdëri, Drejtori i Spitalit fr. Natalino Poggi, Drejtori Mjekësor prof. Fabian Cenko dhe zv. Dekania e Fakultetit të Mjekësisë prof. Anila Godo ndanë takimet dy ditore me Presidentin e Spitalit Bambino Gesù të Romës **Prof. Tiziano Onesti** dhe me bashkëpunëtorët e tij, Drejtorin Mjekësor të kësaj qendre **z. Massimiliano Raponi** dhe përgjegjës për marrëdhëniet ndërkombëtare **z. Alessandro Cristaldi**. Gjatë vizitës në datat 8 dhe 9 Prill u fol gjerësisht për marrëdhëniet mes dy strukturave gjerësisht të njohura në Itali dhe në Shqipëri, duke shtruar rrugët e



të Tiranës. Gjatë vizitës delegacioni vizitoi Spitalin, duke u njohur me standardet e larta strukturore dhe teknologjike që e vendosin atë në nivelet më të larta të cilësisë, edhe bashkëpunimit të profesionistëve të shëndetësisë të përfshirë në aktivitetet universitare italiane dhe shqiptare. Aktualisht është duke u hartuar një marrëveshje formale e cila do të sjellë Spitalin Papës të specializuar në pediatri, në Tokën e Shqiponjave.

Kjo është një ditë e bukur. Disa akte të trashëgimisë njerëzore bashkohen në misionin e tyre për ndihmë, kujdes dhe arsim. Po flasim për spitalin Bambino Gesù që ka një histori domethënëse. I themeluar në vitin 1869 në Romë ky institucion zë një vend të spikatur dhe të shkëlqyer në Evropë dhe në botë, duke qenë edhe një institucion i Selisë së Shenjtë.

Ka shumë të përbashkëta midis nesh: Kongregacioni i Bijve të Zojes së Papërlyer u themelua nga i Lumi Luigi Monti në vitin 1857 në Romë; ndër veprat e tij në Qytetin e Përjetshëm është edhe një spital me një traditë të gjatë dhe ekspertizë të rëndësishme, siç është IDI (Instituti Dermopatik Zoja e Papërlyer); "motivi ideal" i përbashkët

i referohet urdhrin të krishterë për t'u kujdesur për të sëmurët.

Shqipëria bashkon dy realitete protagoniste, Spitali pediatrik Bambino Gesù dhe Fondacioni ynë Zoja e Këshillit të Mirë. FZKM ka qenë i pranishëm në Tokën e Shqiponjave që nga viti 1993 dhe mori emrin nga Maria, nëna e Jezusit, Pajtorja Mbrojtëse e Shqipërisë, e nderuar si "Zoja e Këshillit të Mirë".

Ne jemi një organizatë jofitimprurëse sipas ligjit shqiptar e promovuar nga komuniteti Montian, ku është bashkuar intuïta bujare e Shën Terezës së Kalkutës dhe mbështetja e ndriçuar e qeverisë së kohës që vuri në dispozicion terrenin.

Kanë kaluar tridhjetë vjet, gjatë të cilave u ngritën Poliklinika në qendër të qytetit, UNIKZKM, Qendra e Fizioterapisë, Spitali dhe Klinika Dentare. Spitali Katolik i hodhi hapat e parë në fund të vitit 2022.

Në vitin 2004 nisi veprimtarinë e tij universiteti me të njëjtin emër, i cili kualifikon njësoj si në universitetet shtetërore italiane. Janë mbi 3000 studentë, 800 prej të cilëve italianë.

Ne po shohim horizonte të reja me vende si India dhe Kina.

Po flasim për një takim të gëzueshëm, por çdo takim është gjithashtu i guximshëm, ndaj le të udhëhiqemi nga e mira sepse e mira është burim arritjesh të reja.

Papa Françesku na ka kërkuar prej vitesh të kemi një kishë që fton dhe një "spital fushor", pra që arrin të veprojë në mënyrë praktike.



Ky akt merr edhe kuptim shpirtëror si një shenjë e bujarisë së përgjithshme.

Nëse dy strukturat tona arrijnë të përbashkëtën atëherë trashëgimia do të jetë e mundur dhe do të rizgjojë nevojën për ndërtimin e proceseve që ndryshojnë epoka.



Duke ndërtuar lidhje në rritje atëherë kemi gjetur antidotin që nuk lejon përgjumjen, por zhvillimin.

Pikërisht kjo është ajo që kanë nevojë institucionet tona dhe Kisha dhe Shqipëria ka nevojë për të, si gjithë Ballkani, që jeton ende në një ëndërr që do të mbetet e tillë nëse nuk shoh pjesëmarrjen bujare dhe aktive të punëtorëve të tjerë të paqes që japin kujdes dhe ndihmë, kulturë dhe arsim.

06

LAJMËTARË TË SHPRESËS



Prof. Tiziano Onesti
(President i OPBG)

Qasja me të cilën punojnë delegacionet jashtë vendit ka qenë gjithmonë ajo e zbatimit të misionit apostolik të Atit të Shenjtë dhe të Kishës Katolike në botë. Kjo është mënyra e veprimit e Spitalit Bambino Gesù, i cili vendos në qendër fëmijët dhe familjet e tyre duke ofruar kujdes dhe vëmendje në kohë.

Çfarë na kërkohet nga jashtë?

Të vëmë në dispozicion për të gjithë njohuritë mjekësore që kemi dhe modelin tonë. Sa i përket edukimit po investojmë shumë në shkëmbimin mes specialistëve edhe përmes formimit të vazhdueshëm online dhe telemjekësisë.

Ne gjithmonë u përgjigjemi atyre që kërkojnë ndihmë, nuk jemi tërhequr kurrë. Angazhimi ndërkombëtar për ne do të thotë të sjellim në Romë së bashku me familjet rastet me kompleksitet të lartë shëndetësor, falë sistemit të mikpritjes së Spitalit, i zhvilluar dhe i testuar mirë gjatë viteve, duke patur edhe mbështetjen e rrjetit të vullnetarizmit.

Risia në nivel ndërkombëtar është se Spitali vepron në harmoni midis Selisë së Shenjtë dhe qeverisë italiane, përkrah rrjetit të nunciaturave dhe ambasadave të vendeve ku ne veprojmë, dhe për këtë arsye bashkëbiseduesit janë të shumtë. Kjo mendoj se është domethënia e diplomacisë së shpresës që Ati i Shenjtë synonte për Jubileun që po jetojmë.

07

OPEN DAY: TRADITA VAZHDON



Në datën 12 prill 2025 Kampusi Universitar dhe Spitalor "Zoja e Këshillit të Mirë" hapi dyert për të rinjtë që po bëhen gati të hedhin një hap tjetër të rëndësishëm në jetën e tyre, atë të studimeve universitare.

Tashmë është traditë e konsoliduar prej vitesh që maturantët e të gjithë Shqipërisë dhe jo vetëm, të njihen nga afër me kushtet dhe infrastrukturën e kampusit ndërkombëtar.

Përveçse u njohën me tarifat shumë avantazhuese të këtij viti, të rinjtë dhe prindërit e tyre u takuan me profesorë, koordinatorë, me kuratorët e bibliotekës, vizituan labororet, klinikat e shumta të praktikës mësimore, sallat e mësimi, terrenet sportive dhe hapësirat e dedikuara për jetën sociale gjatë studimeve. Gjatë "Open Day" maturantët vizituan Spitalin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" ku kryhen praktika



Një ftesë për Ty,



të dobishme për programet e studimit që ofron UKZKM. Brenda kampusit studentët orientohen me lehtësi duke kursyer kohën e tyre sepse UKZKM ofron gjithshka brenda një territori të plotë, shumë pranë qendrës së Tiranës, duke lehtësuar edhe kushtet e transportit ditor. 12 prilli ishte menduar deri në detaje



si një ditë njohjeje dhe argëtimi. Të rinjtë jo vetëm morën informacion, por ndoqën organizime të dedikuara nga çdo Program Studimi.

Pedagogët dhe koordinatorët tanë u shpjeguan me profesionalizëm gjithçka duhet për programet tona të studimit



në **Ekonomi, Farmaci, Arkitekturë, Fizioterapi, Infermieri, Odontoiatri dhe Mjekësi.**

Ne në UKZKM jemi shumë krenarë për rezultatet tona në këto 20 vjet dhe kjo duket në arritjet e brezave të studentëve tanë të diplomuar ndër vite që sot nderojnë veten, familjet e tyre dhe ne kudo ku punojnë, në Shqipëri, Bashkimin Evropian, SHBA etj.

UKZKM është i përkushtuar që të mbështesë edukimin cilësor dhe arsimin në nivele ndërkombëtare.

08

SHKOLLA VERORE PËR PAQEN

Summer School mbushi dhjetë vite dhe ky është një moment i rëndësishëm për të festuar. Nuk ka qenë e lehtë të ndërtohej programi dhe koordinimi i këtyre viteve, por sot nëse kthejmë kokën pas në këto dhjetë vjet, duket se ka qenë një përpjekje e suksesshme që ka dhënë rezultate të kënaqshme.

Kjo duket qartë nga numri i lartë i pjesëmarrësve, nga numri dhe kualifikimi domethënës i profesorëve që kanë marrë pjesë ndër vite dhe nga rezultatet e arritura.

Prandaj, sot është dita për të shkruar një letër falënderimi për të gjithë, duke hapur një kapitull të ri premtues.

Në emër të ekipit CESPIC, dëshirojmë t'ju shprehim falënderimet tona të sinqerta për pjesëmarrjen tuaj në **Summer School "Roots of War & Establishment of a Lasting Peace"**. Prezenca dhe angazhimi juaj kontribuan në mënyrë të konsiderueshme në suksesin e këtij event.

Diskutimet e thella, idetë inovative dhe perspektivat e larmishme që ndatë e pasuruan programin tonë dhe

10 vjet
për të festuar
së bashku

hodhën themelet për një kuptim më të thellë të rrënjëve të konfliktit dhe strategjive për ndërtimin e paqes së qëndrueshme. Multikulturalizmi dhe diversiteti i pjesëmarrësve në edicionet e kaluara kanë luajtur një rol vendimtar në promovimin e dialogut të hapur dhe gjithëpërfshirës, duke kontribuar ndjeshëm në cilësinë dhe thellësinë e diskutimeve tona.

Edhe këtë vit **CESPIC** do të propozojë me të njëjtin angazhim Summer School, duke synuar jo vetëm studimin, por edhe reflektimin mbi temat që krijojnë ndjeshmëri në rajon dhe në botë.



09

NJË ÇMIM QË NIS NGA TIRANA

Paqja që na pret



Më 15 maj do të prezantohet zyrtarisht **Çmimi CESPIC për Paqen**. Çmimi është konceptuar dhe promovuar nga **Fondacioni "Zoja e Këshillit të Mirë"** dhe organizimi operativ i tij është besuar **Qendrës Evropiane për Shkencat e Paqes, Integritimit dhe Bashkëpunimit (CESPIC)**, e krijuar nga **Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"** në Tiranë, në bashkëpunim me **Observatorin Ballkan-Kaukaz Transeuropa / Qendrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar (OBCT/CCI)**.

Çmimi u jepet çdo vit një ose më shumë personave ose organizatave që kontribuojnë në promovimin e paqes, me një vëmendje të veçantë për rajonin e Ballkanit. Për këtë qëllim, CESPIC do të koordinojë çdo vit veprimtarinë e një jurie të përbërë nga përfaqësues të akademisë, shoqërisë civile dhe bashkësive fetare nga vende të ndryshme të rajonit. Ceremonia e ndarjes së çmimit do të zhvillohet çdo vit në muajin nëntor.

Në prezantimin e Çmimit do të marrin pjesë: Presidenti i Fondacionit "Zoja e Këshillit të Mirë", Fr. Ruggero Valentini; Rektori i Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", prof. Leonardo Palombi; Drejtori i CESPIC, prof. Raul Caruso; Drejtoresha e OBCT/CCI, dr. Luisa Chiodi; dhe Presidenti i Konferencës Ipeshkvnore të Kishës Katolike në Shqipëri, imzot Gjergj Meta.

Data e prezantimit, e përcaktuar prej kohësh, përkon me ngjarjen e rëndësishme të Samitit të Komunitetit Politik Evropian. Nisma për lançimin e Çmimit CESPIC për Paqen synon të jetë një përshëndetje për liderët e 44 vendeve evropiane që do të jenë të pranishëm në Tiranë, si edhe një ftesë për të punuar për paqen në një kohë kur riarmatimi, siguria dhe lufta janë për fat të keq fjalë të shpërdoruara në marrëdhëniet diplomatike.

Dërgimi i këtij mesazhi nga Ballkani ndihmon për të kujtuar sa e vështirë është të konsolidohen marrëdhëniet dhe bashkëjetesa paqësore dhe se riarmatimi nuk mjafton për t'u dhënë grave dhe burrave një perspektivë të qartë të një jete në paqe.

10

QENDRA PROFESIONALE

Mundësi të reja



Qendra profesionale do të zhvillojë dy profile, atë të **punonjësit shëndetësor dhe social** dhe atë të **programuesit IT**. Kurset do të zhvillohen në Shkodër, në Seminarin Ndërdioqezan të Shkodrës dhe në Elbasan në Fakultetin e Infermierisë të UZKM-së. Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë është duke mbështetur rinovimin e duhur të ambienteve sipas nevojave që kërkohen për mësimin teorik dhe praktik të kurseve profesionale, si dhe kompletimin me pajisjet më moderne e të nevojshme për këtë gjë. Stafi pedagogjik është gati për të filluar aktivitetin trajnues dhe së shpejti do të shpallet data e fillimit të kurseve. Deri më tani ka interesim të madh të të rinjve dhe jo vetëm për të dy profilet e lartpërmenduar.

Të interesuar janë personat që kanë përfunduar shkollën e mesme dhe atë publike, por ka edhe nga ata që kanë marrë një diplomë trevjeçare dhe dëshirojnë të rrisin aftësitë e tyre profesionale për të rritur mundësitë e punësimit brenda dhe jashtë vendit. Stafi drejtues do të zhvillojë takime në rajonet e Trentino-s dhe Lombardisë në fillim të majit për t'u takuar me partnerët italianë, të cilët do të mbështesin me asistencë zhvillimin e kurseve. Lajm i mirë është certifikimi ndërkombëtar dhe praktikat profesionale të studentëve tanë në **Qendrën Profesionale "At Monti"**. Me partnerët tanë do të diskutojmë edhe për hapjen e kurseve të tjera profesionale të nivelit V të kualifikimeve europiane në sektorët e industrisë dhe turizmit.

11

INISIATIVA HUMANE

Një gjest i vogël, një shpëtim i madh

Gjatë datave **7-8-9 Prill 2025** prej mëngjesit në Sallën e praktikës së Infermierisë të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" u krye dhurimi vullnetar i gjakut në bashkëpunim me Organizatën e Dhuruesve Vullnetarë. Studentë dhe vullnetarë anonimë ofruan ndihmën e tyre për t'u ardhur në ndihmë qindra njerëzve që përballen me nevojën për gjak.

Nën kujdesin e mjekëve procesi u monitorua me kujdes duke respektuar parametrat e detyrueshëm shëndetësor për çdo dhurues.



nga **MARIO GRIECO**

prej disa vitesh operator i "OJQ Dokita" në Shqipëri në projektin e studimit dhe asistencës për personat me aftësi të kufizuara.

Kongregata
CFIC

Kongregacioni i Bijve të Zojës së Papërlyer ka qenë i pranishëm që prej viteve 1990 në Shqipëri ku themeloi Fondacionin Zoja e Këshillit të Mirë një organizatë jofitimprurëse sipas ligjit shqiptar. Në Shqipëri Fondacioni përfaqëson karizmën ungjillore të të Lumit Luigji Monti, fetar, infermier dhe edukator. Fondacioni synon të kontribuojë në zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor të shoqërisë shqiptare duke mbështetur progresin e saj, me vëmendje të veçantë ndaj personave vulnerabël dhe të marginalizuar, të sëmurëve, të rinjve, në përputhje me mesazhin e krishterë dhe vlerat e doktrinës sociale të Kishës Katolike.

Fondacioni
ZKM

Në vitin 1995 Fondacioni themeloi Poliambulancën At' Luigji Monti në Tiranë, e cila ofron shërbime për 35,000 pacientë në vit. Në vitin 2004 u themelua Universiteti Katolik Zoja e Këshillit të Mirë, i cili lëshon diploma të përbashkëta me disa universitete shtetërore italiane. Në vitin 2022 në vazhdimësi të aktiviteteve shëndetësore të Poliambulancës Fondacioni hapi Spitalin Katolik, i cili ofron shërbime të specializuara në fusha të ndryshme mjekësore, duke përfshirë trajtimin e sëmundjeve të brendshme, shërbimet kirurgjikale, analizat laboratorike, kardiologjinë, oftalmologjinë dhe fizioterapinë. Tablonë e plotëson Klinika Dentare e themeluar në vitin 2008, e cila ka arritur një nivel të konsiderueshëm shërbimesh, shpesh në dobi të personave me aftësi të kufizuara dhe në nevojë.

Spitali
Katolik
ZKM

Spitali përfshin edhe Qendrën e Rehabilitimit dhe Mjekësisë Sportive, një ekselencë në kujdesin shëndetësor shqiptar për mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara. Struktura e saj moderne përfshin kabina terapeutike, palestra me pajisje të specializuara dhe një pishinë për hidrokinezoterapi. Kjo qendër prezantoi fizioterapinë moderne në Shqipëri, duke formuar në bashkëpunim me Universitetin qindra profesionistë që sot punojnë në Shqipëri ose në vende të tjera të Bashkimit Evropian, si dhe duke ndihmuar shumë njerëz që kanë nevojë për kujdes fizioterapie, të cilët përndryshe do të ishin detyruar të hiqnin dorë ose të shkonin jashtë vendit.

P E R S O N A Z H I | Z K M

Intervistë me **Dr. Florian Spada,**
Përgjegjës i Praktikave Klinike, Fakulteti i Mjekësisë UKZKM, programi Fizioterapi

Si lindi bashkëpunimi juaj me Fondacionin ZKM?

Bashkëpunimi im me Fondacionin lindi nga një dëshirë e thellë për të vënë aftësitë e mia profesionale dhe akademike në shërbim të komunitetit tim. Pas shumë vitesh arsimimi dhe kërkimi, pashë te ky Fondacion një institucion që kombinon vlerat njerëzore, cilësinë e kujdesit shëndetësor dhe një vizion të qartë për të ardhmen e vendit. E fillova rrugëtimin tim në fizioterapi me qëllimin e saktë për të kontribuar në një model kujdesi të përqendruar te personi, dhe Fondacioni përfaqësoi pikërisht këtë filozofi.

Si funksionon Qendra e Rehabilitimit e Fondacionit?

Qendra jonë e Rehabilitimit dallohet për qasjen e saj të integruar dhe multidisiplinare ndaj rehabilitimit. Ne ofrojmë fizioterapi, trajtime neurologjike dhe ortopedike, me teknologji të përparuara, hapësira moderne, përfshirë edhe një pishinë terapeutike, dhe një ekip shumë të kualifikuar. Synimi ynë është të promovojmë autonominë funksionale të pacientit, jo vetëm nëpërmjet terapisë, por edhe përmes përfshirjes dhe fuqizimit social.



Vijon në faqen 10 →

Sot ju ushtroni profesionin e fizioterapistit në vendin tuaj.

Është përgjegjësi e madhe, por edhe nder i madh. Të punoj në Shqipëri do të thotë të jem në gjendje të kontribuoj drejtpërdrejt në zhvillimin e vendit tim, të mbush boshllëqet në shërbimet e rehabilitimit dhe të ofroj mundësi konkrete për të përmirësuar cilësinë e jetës së shumë njerëzve. Është gjithashtu një formë e dhënies së kontributit mbrapsht, sepse besoj thellësisht se ata që kanë pasur mundësinë të arsimohen duhet të kthehen për të investuar në komunitetin e tyre.



Cili është roli i Qendrës së Fizioterapisë së Fondacionit në kontekstin shqiptar?

Qendra përfaqëson një pikë referimi në nivel kombëtar, jo vetëm për cilësinë e kujdesit, por edhe për inovacionin e shërbimeve të ofruara. Ne jemi ndër qendrat e pakta në Shqipëri që zhvillojmë programe specifike për rehabilitimin neurologjik dhe që kemi një vizion të orientuar edhe drejt integritimit social përmes sportit dhe edukimit shëndetësor. Punojmë çdo ditë për të qenë një udhërrëfyes dhe një model për qendrat e tjera në vend.

Çfarë do të thotë për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri të jenë në gjendje të përdorin një Qendër si kjo?

Për shumë persona me aftësi të kufizuara, mundësia për të pasur akses në një Qendër si e jona do të thotë të kenë një shpresë konkrete për përmirësim, autonomi dhe përfshirje. Në një kontekst ku shërbimet janë shpesh të kufizuara ose të paarrtshme, puna jonë merr vlerë të madhe njerëzore dhe shoqërore. Qendra nuk është vetëm një vend terapie, por një hapësirë mirëseardhjeje, dinjiteti dhe mundësie.

Mund të përshkruani objektivat për përmirësimin e nivelit të kujdesit fizioterapeutik për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri.

Ne përqendrohemi në trajnimin e vazhdueshëm të stafit tonë, futjen e teknologjive të përparuara si sistemet e ngritjes përmes makinerive, karriget me rrota ortostatike, robotikën dhe zgjerimin e shërbimeve në shtëpi dhe komunitet. Ne bashkëpunojmë me shoqata dhe organizata ndërkombëtare për të promovuar aktivitetin fizik të adaptuar, përfshirjen sociale dhe të mësuarit e vazhdueshëm. Qëllimi ynë është të ndërtojmë një model rehabilitimi të qëndrueshëm, të aksesueshëm dhe ekselent.

Na tregoni një histori suksesi për të cilën ishte e rëndësishme të ndiqej një trajtim adekuat fizioterapie.

Një rast që e kujtoj me dashuri të veçantë është ai i një pacienteje të re, e cila në vitin 2019, ndërsa ndiqte vitin e parë të universitetit, u godit nga një aksident me makinë. Pas tre muajsh e gjysmë në gjendje koma, ajo mbërriti në qendrën tonë në një karrige me rrota. Procesi i saj i rehabilitimit ishte i gjatë dhe intensiv, por falë fizioterapisë së synuar, këmbënguljes dhe motivimit që ajo demonstroi, sot është në gjendje të jetojë një jetë të pavarur.

Duke marrë pjesë në seancat e palestrës me djem dhe vajza të tjerë dhe duke vazhduar studimet universitare, ajo arriti rezultate që në fillim dukeshin të pamundura. Ky rast është një shembull se si trajtimi i duhur fizioterapeutik dhe mbështetja e duhur mund ta ndryshojnë rrënjësisht jetën e një personi, duke rikthyer jo vetëm funksionin fizik, por edhe shpresën dhe vendosmërinë për të përballur të ardhmen.





Më 20 mars 2025, si pjesë e aktiviteteve të projektit Jean Monnet Module "Harmonizimi i Legjislacionit Farmaceutik Shqiptar me Direktivën Evropiane të Barnave" (PHARM-EU), financuar nga Agjencia Ekzekutive e Arsimit dhe Kulturës Evropiane (EACEA), **Prof Claudio D'Alonzo** nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale në Universitetin Katolik Zoja e Këshillit të Mirë mbajti një leksion të hapur me titull "Përgjegjësitë e prodhuesit të medikamenteve dhe detyra për informim".

Gjatë leksionit u trajtuan disa tema mjaft të rëndësishme, duke përfshirë regjimin e përgjegjësisë që zbatohet në rastet e dëmeve që vijnë nga prodhimi, shpërndarja dhe përdorimi i një produkti mjekësor defektos, si edhe detyra e kompanive farmaceutike për të ofruar informacion. Studentë dhe profesorë nga fakultete të ndryshme të Universitetit morën pjesë aktive në leksion, duke u përfshirë në një diskutim të hapur me docentin.

Në kuadër të projektit evropian "Harmonizimi i Legjislacionit Farmaceutik Shqiptar me Direktivën Evropiane të Barnave" (PHARM-EU), i përfshirë në Modulin Jean Monnet dhe i financuar nga programi Erasmus+ i BE-së, më **25 Mars 2025** u zhvillua me sukses tryeza e rrumbullakët mbi Farmakoekonominë, me pjesëmarrjen e ekspertëve nga sektori farmaceutik dhe ekonomik.

Aktiviteti u moderua nga Prof. Asoc. Malvina Hoxha, organizatore shkencore e aktivitetit, e cila informoi pjesëmarrësit mbi rëndësinë e farmakoekonomisë, duke theksuar rolin e saj thelbësor në optimizimin e burimeve shëndetësore dhe balancimin midis inovacionit dhe qëndrueshmërisë ekonomike në sektorin farmaceutik.

Prof. Roberto Perrone, Dekani i Fakultetit të Farmacisë, mirëpriti të ftuarit dhe theksoi vlerën e farmakoekonomisë në sektorin farmaceutik.

Prof. Fabrizio Gianfrate, ekspert i Ekonomisë Shëndetësore nga Universiteti i Ferrarës, mbajti një prezantim të detajuar mbi konceptet kryesore të farmakoekonomisë, duke vënë në dukje rëndësinë e saj për të siguruar akses të barabartë në barna dhe shpërndarjen optimale të burimeve.

Dr. Bujar Shala, Konsulent Ekonomik në Qendrën e Kërkimeve Shkencore të Spitalit Universitar të Oslos, ilustroi strategjitë për përmirësimin e



efikasitetit të shpenzimeve farmaceutike, duke analizuar ndikimin e politikave të çmimeve dhe duke ofruar shembuj praktikë të optimizimit ekonomik në sektorin shëndetësor.

Dr. Ermira Krasniqi kontribuoi me një përmbledhje legjislative, duke analizuar aspektet rregullatore të lidhura me farmakoekonominë dhe duke diskutuar implikimet e ligjeve aktuale mbi aksesin e barnave në Kosovë.

Studentet e vitit të pestë të Farmacisë **Kamila Domi, Frenki Çipi, Artejana Marku, Xhoana Tahiraj** dhe **Chantal Koloneci** ndanë reflektime të vlefshme mbi sfidat e realizimit të një studimi farmakoekonomik, duke pasuruar diskutimin me perspektivat e tyre.

Tryeza e rrumbullakët u mbyll nga koordinatoreja shkencore e projektit PHARM-EU, Prof. Asoc. Malvina Hoxha, e cila theksoi rëndësinë e bashkëpunimit për të adresuar sfidat e farmakoekonomisë dhe për të promovuar një sistem shëndetësor më efikas.

14

RËNDËSIA E PROMOVIMIT TË INOVACIONIT NË MËSIMDHËNIE

ERASMUS+

Universitetet
e së Ardhmes

Elona Mëhilli, profesoreshë e Gjuhës e kulturës Angleze në Universitetin Katolik Zoja e Këshillit të Mirë, pati nderin të përfaqësojë institucionin tonë në Javën Ndërkombëtare të stafit, e cila u mbajt nga 10 deri më 14 mars 2025 pranë Universitetit Katolik të Lilës, në kuadër të mobilitetit për trajnim në Erasmus+.

Ky event prestigjioz mblodhi 50 akademikë nga universitetet partnere nga Evropa, Lindja e Mesme, Afrika dhe Azia, duke nxitur dialog dhe bashkëpunim global.

Tema e këtij viti, Universitetet e së Ardhmes, u fokusua në shkëmbimin e praktikave më të mira dhe në fitimin e njohurive mbi projektet inovative që po formojnë të ardhmen e arsimit të lartë. Një nga diskutimet kryesore gjatë javës u përqendrua në sfidat që universitetet



përballen në mbarë botën, ndërsa ato përshtaten me arsimin që po ndryshon shpejt. Prof. Mëhilli mori pjesë në një sërë aktivitete, workshopesh dhe vizitash në kampusin francez ku u prezantuan iniciativat për zhvillim të qëndrueshëm.

Gjatë këtij event gjithashtu u theksua rëndësia e nxitjes së inovacionit në mësimdhënie dhe të mësuarit dhe futja e metodave të reja për të përmirësuar angazhimin e studentëve dhe praktikën universitare.

Pjesëmarrja e Prof. Mëhillit në këtë ngjarje të rëndësishme thekson angazhimin e universitetit tonë përballë ndryshimeve globale, atyre në arsim si edhe forcon partneritetet ndërkombëtare.



15

NJË VIZITË E DOBISHME DHE E ÇMUAR

Vizitë në Bankën e Shqipërisë

Studentët e vitit të parë dhe të dytë të Programit të Studimit në Ekonomi morën pjesë në një vizitë didaktike në godinën historike të Bankës së Shqipërisë.

Të shoqëruar nga **Prof. Gianpiero Maci** si drejtues i lëndës së Ndërmjetësve Financiarë, nga **Prof. Asoc Klodian Muço** dhe **PhD Bardha Karra** studentët njohën disa nga proceset e punës në Bankën e Shqipërisë, e cila mbushi njëqindvite nga themelimi i saj.



Praktika didaktike në institucionet financiare të vendit tashmë është një traditë e konsoliduar në Programin e Studimit në Ekonomi pranë UKZKM, duke rikonfirmuar për studentët tanë standardet akademike dhe përfitimet e vërteta që marrin të diplomuarit në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë".

Nga hulumtimet e kryera rezultoi se 96% e të diplomuarve në Ekonomi pranë UKZKM punësohen menjëherë pas përfundimit të studimeve.

NJË REFLEKTIM I THELLË MBI ROLIN E ANESTEZISTIT

Një fjalim në Konferencën Vjetore të Organizatës Shqiptare të Anestezistëve



Në datën **12 Prill** u mbajt konferenca e përvitshme e Organizuar nga Shoqata Shqiptare e Anestezistëve, ku lektori i parë, që hapi konferencën ishte **Fr. Ruggero Valentini**, President i Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë.

Në fjalimin e tij, të titulluar "Anestezistët në udhëkryqin e jetës", Fr. Ruggero Valentini, president i fondacionit "Zoja e Këshillit të Mirë", propozoi një reflektim të thellë mbi rolin e anestezistit, një figurë mjekësore që shpesh vendoset përballë momenteve më delikate të ekzistencës: lindja, sëmundja, vuajtja, vdekja.



Duke u nisur nga konteksti bashkëkohor, i përcaktuar nga Papa Françesku si një "ndryshim epokal", Fr. Valentini vuri në pah sfidat etike, kulturore dhe sociale me të cilat po përballlet mjekësia sot: nga teknologjizmi i tepërt deri te humbja e dimensionit të ndërsjelltë dhe human, nga medikalizimi i shoqërisë deri te kriza e profesioneve shëndetësore.

Sipas udhëzimeve të Shoqatës Italiane të Anestezisë, Analgjesisë, Reanimacionit dhe Terapisë Intensive (SIART) është e domosdoshme të njihet dhe të kuptohet roli thelbësor i bioetikës, duke theksuar nevojën për të bashkuar shkencën dhe humanizmin në shërbim të jetës, pikërisht në momentin kur ajo ka më së shumti nevojë për mjekësinë.

Fr. Ruggero Valentini kujtoi më në fund **figurën e mjekut Emanuele Stabum, frymëzuesin e veprës shëndetësore të kongregatës "Bijtë e Zojës së Papërlyer"**, i cili na ftoi të "kërkojmë gjithmonë mes skutave të një dhimbjeje, vuajtjen e një shpirti".

Anestezisti, një dëshmitar i heshtur, por qendror në procesin e trajtimit, zbulon kështu veten si një figure të qëndrueshme dhe shprese, e aftë për të pohuar dinjitetin dhe vlerën e njeriut human, edhe në momente ekstreme.

SHËRBIMI I MENSËS I RINOVUAR

Kampi ynë universitar ofron studentëve mundësinë për të gjetur të gjitha shërbimet që u nevojiten brenda tij. Një prej këtyre shërbimeve është mensa, e cila përfshin gjithashtu shërbimin e kafenesë.

Për së fundmi, me një organizim të ri, mensa është transformuar dhe ofron një shërbim më të mirë në lidhje me ushqimin, pijet të ngrohta dhe të ftohta, vet-shërbimin dhe menunë të skanuar, e cila redukton kohën e pritjes për studentët për porositë e tyre. Shefi i ri i mensës, **Klodian Bodeci**, thotë se qëllimi kryesor i zvogëlimit të shërbimit dhe ristrukturimit të hapësirave ishte rritja e cilësisë së shërbimit dhe krijimi i një hapësire mikpritëse për të rinjtë që kalojnë shumicën e ditës në kampus.



Hapësirë për studentet

Mensa dhe kafeteria ndodhen në zemër të kampusit, të rrethuara nga Kopshti i të Drejtëve dhe fusha sportive, dhe ofrojnë një pamje të bukur mbi hapësirat e gjelbra të UKZKM.

PELLEGRINAGGIO A SCUTARI

 **26 aprile 2025**

 **7:30**

 **PARTENZA IN AUTOBUS
dall' UNIVERSITÀ CATTOLICA "NSBC"
Tirana-Albania**

 Per prenotazioni entro **24.04.2025**:
Segreteria della Fondazione:
 k.dema@fzkm.org



- Santa Messa
al Santuario NSBC
- Visita guidata
al Castello di Rozafa
- Cena all'Agritour
"Mrizi i Zanave"



**Fondazione
Nostra Signora del Buon Consiglio
Tirana**

Dedicata all'educazione, dedicata alla salute

FESTA della FONDAZIONE

 **29 aprile 2025**

 **17:00**

 **UNIVERSITÀ CATTOLICA "NSBC"
Tirana-Albania**

- SANTA MESSA
- CORSA A STAFFETTA
- BORSE DI STUDIO
- CONCERTO LIVE
- GIOCHI DI PRESTIGIO
- DJ
- BUFFET

Insieme si fa festa!



Faqja e kulturës



Ardita Pinari

Do të kisha dashur

Do të kisha dashur të të quaja David si statuja në Firenze, një trup i fuqishëm, një buzeqeshje rrezëllitëse, ato sy të qeshur, buzë mishtore, kaq tërheqës sa të shkrijë e gjithë Antarktida.

Egocentrik sapo fillon të flasësh, kaq krenar sa për të gjuhëzuar një popull të tërë, dhe në fund ata si ty dergjen në shtratin e vdekjes pa kurrfarë dashurie. Do të doja të të kisha folur e të të thoja që bota nuk është e jotja i dashuri im "Zeus",

ka jetë dhe ka vdekje dhe në fund askush nuk të konsideron për aq kohë sa ti nuk di të ndjesh e të kthesh.

E ndërsa ti i quan ëndërrimtarë ata që ushqehen me dashuri, ti venitesh sepse nuk e kupton se çfarë do të thotë ajo fjalë.

Do të jesh një hije e padobishme pranë kujtdo, dhe një ditë roli yt prej "Zeusi" do të zhduket.

Pusho në paqe në shtratin e vdekjes, tashmë askush nuk ka lot për ty, pasi nuk dite kurrë të dashurosh, por vetëm të lëndosh.

poezi

Takimet e ardhshme



SEMINARIO TEORICO E PRATICO DI DERMATOLOGIA

DERMATOSCOPIA impara a usarla

5 Maggio 2025

11:30

AULA B105
Università Cattolica
"Nostra Signora
del Buon Consiglio"
Tirana-Albania



Relatore
Dott.ssa AMARDA CENKO
Dermatologa,
Ospedale Cattolico NSBC

CONVEGNO INTERNAZIONALE

ITALIA-ALBANIA

Il ruolo delle Donne tra Scienza, Arte,
Storia ed Economia
Incontro interfaccoltà ed interuniversità

6 maggio 2025

09:00-18:00

AULA MAGNA
UNIVERSITÀ CATTOLICA "NSBC"
Tirana-Albania

Comitato Organizzatore
Prof.ssa Serena Petrillo
Prof.ssa Ersilia Buonomo
Prof.ssa Bruna Marzucchini
Dott.ssa Elide Pro

Comitato Scientifico
Prof.ssa Serena Petrillo
Prof.ssa Stefania Annarita Nottola
Prof. Guido Macchiarelli
Prof Ferruccio Canal

Convegno organizzato nell'ambito del Gender Equality Plan
Per informazioni rivolgersi alla Prof.ssa Serena Petrillo ☎+393348407335



CONVEGNO SVILUPPO LOCALE E SOSTENIBILITÀ

7 maggio 2025

09:30-17:30

AULA B105
UNIVERSITÀ CATTOLICA "NSBC"
Tirana-Albania



7° Conferenza internazionale

Radici di cura e innovazione:
l'eredità di Padre Luigi Maria Monti
nell'Infermieristica Moderna

26 Maggio 2025

09:00-18:00

AULA MAGNA
Università Cattolica
"Nostra Signora
del Buon Consiglio"
Tirana-Albania



telc
PROVIMI I GJUHËS
GJERMANE



X CONGRESSO DILLE

LINGUE, TERRITORI E CONTESTI:
LE POLITICHE LINGUISTICO-EDUCATIVE OGGI

22-24 MAGGIO 2025

Università Cattolica
"Nostra Signora del Buon Consiglio"
Tirana, Albania





***Kopje të librit mund ti gjeni në Bibliotekën
"Fratel Paolo Ruatti"
pranë Universitetit Katolik
"Zoja e Këshillit të Mirë", Tiranë***

